

## EMPIRICAL ANALYSIS OF THE SEXUAL ABUSE AS A PENAL ACT: EVIDENCE FROM THE REGION OF GOSTIVAR

Fjolla Ejupi

South East European University, North Macedonia, [fe23426@seeu.edu.mk](mailto:fe23426@seeu.edu.mk)

**Abstract:** The phenomenon of the sexual abuse is present in all the regions of the world, regardless of the country's development, as well as the age, race and gender of the abusers. Furthermore, as a penal act itself, can be explained as an act of force or attempt used for obtaining sexual act, without the willingness or against the victim. As such, there are numerous scholars, NGOs, policy makers that have been dealing with this phenomenon and the factors that can influence such sexual abuse acts.

Thus, having into consideration the importance of the treatment of the sexual abuse acts as well as determining the factors by which can be influenced, main objective of this paper is to investigate the sexual abuse acts that have happened in the region of Gostivar, North Macedonia, for the time span 2014 – 2018. In addition to such empirical findings from the descriptive analysis, this paper tries to give a comprehensive regional comparison of the region of Gostivar, by analyzing the differentiation of the verdicts of the Appeal Court of Gostivar with regard to the penal acts of the sexual abuse in the region of Gostivar, for the analyzed period 2014 - 2018.

**Keywords:** sexual abuse, penal act, comparative descriptive analysis

## ANALIZA EMPIRIKE E ABUZIMIT SEKSUAL SI AKT PENALE: DËSHMI NGA QARKU I GOSTIVARIT

Fjolla Ejupi

Universiteti i Evropës Juglindore, Republika e Maqedonisë së Veriut, [fe23426@seeu.edu.mk](mailto:fe23426@seeu.edu.mk)

**Abstrakt:** Fenomeni i abuzimit seksual është i pranishëm në të gjitha regjionet e botës, pavarësisht nga zhvillimi i vendit, si dhe nga mosha, raca dhe gjinia e dhunuesve dhe të dhunuarve. Për më tepër, si vepër penale në vetvete, mund të shpjegohet si një akt dhune ose tentativë e përdorur për kryerjen e aktit seksual, pa vullnet ose kundër vullnetit të viktimës. Si të tillë, ka shumë studiues, OJQ, politikëbërës që janë marrë me këtë fenomen si dhe studime mbi faktorët që mund të ndikojnë akte të tilla të abuzimit seksual.

Pra, duke pasur parasysh rëndësinë e trajtimit të akteve të abuzimit seksual si dhe përcaktimin e faktorëve nga të cilët mund të ndikohen aktet e tilla, qëllimi kryesor i këtij punimi është të hetojë aktet e abuzimit seksual që kanë ndodhur në rajonin e Gostivarit, në Maqedoninë e Veriut, për periudhën kohore 2014 – 2018. Krahas gjetjeve të tilla empirike nga analiza përshkruese, ky punim përpiqet të japë një krahasim gjithëpërfshirës rajonal të Gostivarit, duke analizuar diferencimin e aktgjyqimeve të Gjykatës së Apelit të Gostivarit në lidhje me veprat penale të keqpërdorimit seksual në rajonin e Gostivarit, për periudhën e analizuar 2014 - 2018.

**Fjalë kyçe:** abuzim seksual, akt penal, analizë përshkruese krahasuese

### 1. HYRJJE

Abuzimi seksual është një term ombrellë që përfshin një gamë të gjerë të sjelljeve seksuale jokonsensuale. Për më tepër, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e përkufizon sulmin seksual si “çdo akt seksual, tentativë për të përfituar një akt seksual ose akt tjetër që drejtohet kundër seksualitetit të personit duke përdorur shtrëngim, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia me të viktimës, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpinë dhe punën” (World Health Organization, 2017).

Definime të tjera të organizatave të ndryshme joqeveritare definojnë sulmin seksual si akt seksual të kryer kundër dikujt pa pëlqimin e personi, duke përfshirë aktet seksuale të marra me forcë, shtrëngim dhe ndaj individit të paafte për të dhënë pëlqimin për shkak të moshës, paafetësisë ose dëmtimit pas substancës të përdorur me vullnet ose pa vullnet (Basile et al., 2014). Edhe pse definime të shumta mund të cekën për sa i përket abuzimit seksual, dhe të njëjtat në vete nuk përmbajnë dallim për sa i përket gjinisë së dhunuesit, studime të shumta kanë dëshmuar që gjinia femërore janë më të prekura nga akti i abuzimit seksual. Për më tepër, meshkujt kanë më tepër gjasa të jenë autorët e sulmeve seksuale në krahasim me gjininë femërore.

Dhuna seksuale e kryer në mjedisë konflikti është e lidhur edhe me rritjen e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Dhuna në familje, martesat e fëmijëve dhe shfrytëzimi seksual janë përkeqësuar të gjitha në mjediset

humanitare për shumë arsye, nga ndarja e familjes, tek pasiguria ushqimore dhe mosndëshkimi i autorëve. Përdhunimi dhe sulmet seksuale kryhen gjithashtu nga oportunitizmi individual në një kontekst të paligjshëm. Për më tepër, dhuna seksuale është një fenomen social që ekziston në çdo shoqëri që pranon sjellje agresive dhe pabarazi gjinore, dhe Republika e Maqedonisë së Veriut është në mesin e tyre. Përtej lëndimeve dhe sëmundjeve, ndikimet psikologjike dhe sociale të poshtërimit dhe turpfit janë gërryese për viktimat dhe komunitetet e tyre. Viktimat zakonisht përjashtohen nga familjet dhe komunitetet e tyre dhe fëmijët e lindur nga përdhunimi përballen me stigmatizimin dhe refuzimin gjatë gjithë jetës. Për më tepër, komunitetet dhe autoritetet dështojnë të mbajnë përgjegjësi autorët, duke preferuar të ruajnë një status quo-në, duke mundësuar mosndëshkimin dhe duke nxitur një spirale në rënie të abuzimeve.

Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e dhunës seksuale si dhe trajtimit të saj si një akt penal mjaftë i komplikuar dhe i vështirë për tu zgjidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, qëllimi kryesor i këtij punimi është që hulumtoj fillimisht literaturën ekzistuese për sa i përket abuzimit seksual si akt penal në botë dhe rajon, si dhe të bëjë një analizë deskriptive krahasuese për sa i përket verditkteve të akteve të abuzimit seksual në rajonin e Gostivarit, duke shfrytëzuar të dhëna dytësore të grumbulluara nga Gjykata e Apelit të rajonit të Gostivarit për periudhën kohore 2014 – 2018.

Për më tepër, struktura e këtij punimi është e organizuar si në vijim: Në pjesën e parë që i dedikohet hyrjes, është shtjelluar problematika dhe rëndësia e abuzimit seksual si një akt penal si dhe janë trajtuar definime të ndryshme të tij si dhe objektiva kryesore e punimit, në pjesën e dytë janë trajtuar disa studime dhe raporte të rëndësishme që kanë të bëjnë me aktin penal të abuzimit seksual, kurse në pjesën e tretë është shpjeguar dhe trajtuar metodologjia hulumtuese që është përfshirë në analizën empirike të këtij punimi. Për sa i përket pjesës së katërt, janë diskutuar gjetjet dhe rezultatet e analizës empirike të studimit të abuzimit seksual si vepr penale në rajonin e Gostivarit, kurse pjesa e fundit i dedikohet përfundimeve dhe sugjerimeve të caktuara që lindin nga rezultatet empirike të këtij hulumtimi.

## 2. RISHIKIMI I LITERATURËS

Ekzistojnë punime dhe hulumtime të shumta të cilët kanë analizuar abuzimin seksual si një vepr penale e cila shkakton pasoja të shumta tek të dhunuarit, ku në raste të shumta është dëshmuar që janë persona të moshës të mitur, gjinisë femërore dhe me aftësi të kufizuara. Për më tepër, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e përkufizon sulmin seksual si “çdo akt seksual, tentativë për të përfituar një akt seksual ose akt tjetër që drejtohet kundër seksualitetit të personit duke përdorur shtrëngim, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë” (World Health Organization, 2017).

Është e rëndësishme të theksohet se nga pikëpamja ligjore, moshja e pëlqimit, moshja në të cilën individët shihen si juridikisht kompetentë për të dhënë pëlqimin për kontakt seksual, ndryshon në vende të ndryshme. Për shembull, shumica e vendeve në Evropë e vendosin moshën e pëlqimit midis 14 vjeç dhe 16 vjeç, megjithëse ka disa përjashtime të dukshme, si Franca, e cila nuk ka asnjë moshë të përcaktuar ligjërisht të pëlqimit (Doezema, 2018; Ferguson, 2018).

Kontakti seksual i padëshiruar është një lloj sulmi seksual dhe i referohet puthjes ose prekjës së pjesëve intime të trupit (p.sh., gjinjë, zonën gjenitale, vithet) të një personi nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës fizike, ose shfrytëzimit të paaftësisë së tjetrit për të dhënë pëlqimin ose për të treguar rezistencë aktive, për shembull për shkak të alkoolit ose përdorimit të substancave të tjera (Koss et al., 2007). Nga ana tjetër, ngacmimi seksual përkufizohet si “çdo sjellje seksuale e qëllimshme ose e përsëritur që është e padëshirueshme për marrësin, si dhe sjellje të tjera të lidhura me seksin që krijojnë një mjedis që është armiqtësor, fyes ose degradues” (Fitzgerald, 1993).

Nga studime të kryera të dhunës seksuale në Shtetet e Bashkuara, një studim kombëtar i grave zbuloi se afërsisht 36% kishin përjetuar një formë të sulmit seksual, duke përfshirë penetrimin jokonsensual, kontakti i padëshiruar seksual dhe/ose seksi i marrë nëpërmjet presionit verbal ose manipulimit (Smith et al., 2017).

Për sa i përket studimit të realizuar për vendet në Evropë, Krahe et al., (2015) në hulumtimin e tyre kanë zbuluar që prevalenca e çdo kontakti seksual jokonsensual të marrë me forcë ose kërcënim me forcë që nga moshja 14 vjeçare varronte në vende të ndryshme nga 12 deri në 36% midis grave, me një prevalencë totale të sulmeve seksuale prej 19.5%.

Gjatë një anketimi të 17,000 individëve të realizuar në Australia, u zbulua që ekziston një prevalencë gjatë jetës së sulmeve seksuale prej 17.1% në mesin e grave, ku sulmi seksual përkufizohet si çdo incident i përdhunimit të përfunduar ose tentativës ose prekjës seksuale të kryera nga përdorimi i kërcënimit, dhunës ose frikësimit (Cox, 2016). Nga ana tjetër, edhe pse shumë të kufizuara janë të tilla studime për sa i përket dhunës seksuale, vlerësimet e përgjithshme të prevalencës seksuale gjatë gjithë jetës sulmet në mesin e grave variojnë nga 4.5 në 21% në Afrikë, nga 6 në 12% në Amerikën Qendrore dhe të Jugut dhe nga 3 në 12% në Azi (Abrahams et al., 2014).

### 3. MATERIALI DHE METODAT

Me qëllim të realizimit dhe përmbushjes së qëllimit kryesorë të këtij punimi, respektivisht të hulumtimit të rasteve të veprës penale të abuzimit seksual në rajonin e Gostivarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë grumbulluar të dhëna dytësore të marra nga Gjykata e Apelit të rajonit të Gostivarit për periudhën kohore 2014 – 2018. Për më tepër, në këtë drejtim është përdorur fillimisht metoda dogmatike juridike si dhe metoda krahasuese dhe përshkruese e të dhënave të dhunës seksuale si vepër penale të regjistruara nga ana e Gjykatës së Apelit të Gostivarit, duke përfshirë periudhën pesë vjeçare 2014 – 2018.

Për më tepër, të dhënat sekondare të trajtuara në këtë punim janë grumbulluar në mënyrë zyrtare përmes një kërkese zyrtare deri tek Gjykata e Apelit të rajonit të Gostivarit për periudhën përkatëse.

### 4. GJETJET EMPIKE

Duke pasur parasysh qëllimin primar të këtij studimi që është të analizohen të dhënat e abuzimit seksual si vepër penale në rajonin e Gostivarit, fillimisht në vijim janë trajtuar definimet e veprës penale të abuzimit seksual dhe të dhunimit duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për më tepër, abuzimi seksual si vepër penale sipas Kodit penal të RNM përkufizohet si “vepër tipike e detyrimit dhe kanosjes ndaj personit tjetër me qëllim të kryerjes së aktit seksual. (Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut). Kurse nga ana tjetër, neni 186 i Kodit penal të RNM e përkufizon dhunimin si akt i “përdorimit të forcës ose kërcënimit direkt për të atakuar jetës apo trupin e viktimës, ose ndaj jetës dhe trupit të ndonjë të afërmi të tij, ku kryesi i aktit seksual do të dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet. (Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut,2012).

Për më tepër, me qëllim të analizimit të dhënave sekondare të grumbulluara për periudhën kohore 2014 – 2018, për sa i përket abuzimit seksual si vepër penale të regjistruara nga ana e Gjykatës së Apelit, janë përshkruar dhe krahasuar vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit për sa i përket aktgjykimeve të dhunës seksuale të regjistruara në rajonin e Gostivarit për periudhën kohore 2014 – 2018.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna deskriptive për sa i përket aktvendimeve të dhunës seksuale në rajonin e Gostivarit për periudhën kohore 2014 – 2018, me ç’rast siç edhe mund të vërehet, nga gjithsej 20 aktgjykime, 11 nga to rezultojnë të jenë aktgjykime dënuese kurse 9 prej tyre janë aktgjykime liruese.

**Tabela1. Aktgjykimet e veprës penale të dhunës seksuale**

AKTGJYKIME TË DHUNËS SEKSUALE	VENDIMI
Aktgjykime dënuese	11
Aktgjykime liruese	9

Burimi: të dhëna zyrtare nga Gjykata e Apelit të Gostivarit.

Për më tepër, në tabelën në vijim janë ilustruar edhe vendimet e ankesës që kanë të bëjnë me numrin total të aktvendimeve gjyqësore të shkallës së parë nga ana e Gjykatës së Apelit të rajonit të Gostivarit për periudhën 2014 – 2018. Siç mund të shihet, nga gjithsej 20 ankesa në lidhje me aktgjykime të shkallës së parë, 13 ankesa janë refuzuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë, 5 ankesa janë pranuar për të rishqyrtuar vendimin e shkallës së parë dhe 2 ankesa janë pranuar dhe kanë ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë.

**Tabela2. Vendime t e Gjykatës së Apelit - Gostivar**

VENDIMET E GJYKATËS SË APELIT - GOSTIVAR	NUMRI I VENDIMEVE
Refuzimi i ankesës – vërtetimi i aktgjykimin të shkallës së parë	13
Pranimi i ankesës – rishqyrtim në shkallë të parë	5
Pranimi i ankesës - gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë	2

Burimi: kalkulime të autorit.

Në tabelën në vijim jam ilustruar të dhëna në lidhje me sanksionet penale – dënimet të cilat janë shqiptuar gjatë aktgjykimeve në shkallën e parë – Gjykata Themelore në rajonin e Gostivarit, për abuzime seksuale si vepër penale të regjistruara gjatë periudhës 2014 – 2018. Për më tepër, mund të shohim se si dënime më të shpeshta hasim ato më

të ulëta, që përfshin burgim prej 1.6 vjet deri në 1.8 vjet burgim, kurse si sanksione më të larta janë shqiptuar dënime prej 3 vite deri me 5 vite burgim. Një nga sanksionet më të rralla që është hasur gjatë kësaj periudhe ka qenë shqiptimi i sanksionit të mjekimit të detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtja në institucion shëndetësor.

**Tabela3. Sanksionet për veprën penale – abuzim seksual**

LLOJET E DËNIMIT – SANKSIONIT TË SHQIPTUARA	KOHËZGJATJA E SANKSIONIT
Burgim (sanksion më i ulët)	1 .6 – 1.8 vjet
Burgim (sanksion më i lartë)	3 – 5 vjet
Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor.	2 vjet

Burimi: burime të autorit.

Një nga elementet e cila është e rëndësishme gjatë analizimit të kryerësit të veprës penale – abuzim seksual, është gjithashtu edhe mosha e tyre. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna për sa i përket moshës së kryerësve të abuzimit seksual të regjistruar në Gjykatën e Apelit në rajonin e Gostivarit gjatë periudhës 2014 – 2018. Për më tepër, mund të vërehet që shumica e kryerësve të veprës së abuzimit seksual i takojnë grup moshës prej 30 – 50 vjeç, ndërsa mosha më e ulët dhe ajo më e vjetër shënon vetëm nga një kryerës të veprës së abuzimit seksual.

**Tabela 4. Moshë e kryerësve të abuzimit seksual në rajonin e Gostivarit, 2014 – 2018.**

KATEGORIA E MOSHËS	NURMI I KRYERËSVE
20 – 25 vjeç	1
25 – 30 vjeç	3
30 – 40 vjeç	6
40 – 50 vjeç	7
50 – 60 vjeç	2
mbi 60 vjeç	1

Burimi: kalkulime të autorit.

## 5. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Siç edhe dihet, dhuna seksuale është një fenomen social që ekziston në çdo shoqëri dhe Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është një përjashtim. Ekzistojnë definicione të ndryshme për sa i përket abuzimit seksual, megjithatë si më e pranueshme është ajo që e përcakton atë si një akt seksual të kryer kundër dikujt pa pëlqimin e personi, duke përfshirë aktet seksuale të marra me forcë, shtrëngim dhe ndaj individit të paafte për të dhënë pëlqimin për shkak të moshës, paaftësisë ose dëmtimit pas substancës të përdorur me vullnet ose pa vullnet. Duke patur parasysh vështirësinë dhe ndjeshmërinë që kjo temë në vete ngërthen, mund të themi se edhe pse është një çështje mjaftë e diskutuar dhe hulumtuar, përsëri në vendet e vogla si Republika e Maqedonisë së Veriut, nuk paraqet një tematikë e cila është dukshëm e diskutuar dhe analizuar publikisht. Andaj dhe qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë rastet e dhunës seksuale në rajonin e Gostivarit duke u bazuar në të dhënat sekondare zyrtare të grumbulluara nga Gjykata e Apelit të Gostivarit për periudhën 2014 – 2018.

Bazuar nga rezultatet empirike nga rastet e regjistruara të abuzimit seksual, mund të konkludojmë që gjatë këtyre viteve janë relativisht rastet të cilët kanë përfunduar si të regjistruara në Gjykatën e apelit, me ç'rast vetëm 20 raste janë të regjistruara në organet e drejtësisë. Rezultatet e tilla tregojnë që Republika e Maqedonisë së Veriut, duhet të ndërmerri hapa konkret në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë si dhe të viktimave, ku në të shumtën e rasteve ndodh që vepra të tilla edhe pse ndodhin nuk arrijnë në derën e organit të drejtësisë. Nga hulumtimi i deritanishëm kam vërejtur që gjykatat e vendit nuk i shqiptojnë në masë të duhur lartësinë e dënimit të paraparë me ligjin penal, me ç'rast gjithmonë kanë shqiptuar dënim minimal, edhe atëherë kur ka pasur fakte dhe prova të mjaftueshme si dhe rrethana rënduese që është dashur që kryerësit e këtyre veprave penale nënçmuese të marrin dënime të larta.

## REFERENCAT

Abrahams, N., Devries, K., Watts, C., Pallitto, C., Petzold, M., Shamu, S., & García-Moreno, C. (2014). Worldwide prevalence of non-partner sexual violence: a systematic review. DOI: 10.1016/S0140-6736(13)62243-6.

- Breiding, M., Smith, S., Basile, K., Walters, M., Chen, J., & Merrick, M. (2014). Prevalence and Characteristics of Sexual Violence, Stalking, and Intimate Partner Violence Victimization - National Intimate Partner and Sexual Violence Survey, United States, 2011. Morbidity and mortality weekly report. Surveillance summaries (Washington, D.C.: 2002). 63. 1-18. 10.2105/AJPH.2015.302634.
- Cashmore, J., Parkinson, P., & Taylor, A. (2018) Trends in prosecutions for child sexual abuse in South Australia 1992–2012. *Adelaide Law Review*, 39, 99– 124
- Doezema, T., Ludwig, D., Macnaghten, P., Shelley-Egan, C., & Forsberg, E.M. (2018). [Translation, transduction, and transformation: expanding practices of responsibility across borders](#), *Journal of Responsible Innovation* 6 (3), 323-331
- Ejupi, F. (2019). Vepra penale e dhunimit në rrethin e Gjykatës së Apelit në territorin e Gostivarit për periudhën kohore 2014 – 2018.
- Ferguson, C., Wright, S., Death, J., Burgess, K., & Malouff, J. (2018). Allegations of child sexual abuse in parenting disputes: an examination of judicial determinations in the Family Court of Australia. *Journal of Child Custody*, 15(2), 93– 115.
- Fitzgerald, L. F. (1993). Sexual harassment: Violence against women in the workplace. *American Psychologist*, 48(10), 1070–1076. <https://doi.org/10.1037/0003-066X.48.10.1070>
- Higgins, D., Sanders, M., Lonne, B. & Richardson, D. (2019) Families—private and sacred: how to raise the curtain and implement family support from a public health perspective. In: B. Lonne, D. Scott, D. Higgins & T.I. Herrenkohl (Eds.) *Re-visioning public health approaches for protecting children (Vol 9)*. Switzerland: Springer, pp. 127– 143.
- Krahé, B., Berger, A., Vanwesenbeeck, I., Bianchi, G., Chliaoutakis, J., Fernández-Fuertes, A.A., Fuertes, A., de Matos, M. G., Hadjigeorgiou, E., et al. (2015). Prevalence and correlates of young people's sexual aggression perpetration and victimisation in 10 European countries: a multilevel analysis, *Culture, Health & Sexuality: An International Journal for Research, Intervention and Care*, DOI: [10.1080/13691058.2014.989265](https://doi.org/10.1080/13691058.2014.989265)
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 142, datë 13.11.2012/10.11.2015, Kreu XIX –“Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor”.
- Koss, M. P., Abbey, A., Campbell, R., Cook, S., Norris, J., Testa, M., Ullman, S., West, C., & White, J. (2007). Revising the SES: A collaborative process to improve assessment of sexual aggression and victimization. *Psychology of Women Quarterly*, 31(4), 357–370. <https://doi.org/10.1111/j.1471-6402.2007.00385.x>
- Lubit, R. (2019) Valid and invalid ways to assess the reason a child rejects a parent: the continued malignant role of “parental alienation syndrome”. *Journal of Child Custody*, 16(1), 42– 66.
- Meier, J.S. (2021) Denial of family violence in Court: an empirical analysis and Path Forward for Family Law. GW Law Faculty Publications & Other Works (No. 1536): [https://scholarship.law.gwu.edu/faculty\\_publications/1536](https://scholarship.law.gwu.edu/faculty_publications/1536)
- Smith, E.N., Romero, C., Donovan, B., Herter, R., Paunesku, D., Cohen, G.L., Dweck, C.S., Gross, J.J. (2017). Emotion theories and adolescent well-being: Results of an online intervention. *Emotion*. 2018 Sep;18(6):781-788. doi: 10.1037/emo0000379. Epub 2017 Dec 21. PMID: 29265838.
- World Health Organisations (2017). World Health Statistics 2017: monitoring health for the SDGs, Sustainable Development Goals ISBN 978-92-4-156548-6.